

KRYQI I KUQ I KOSOVËS



SHËRBIMI I KËRKIMIT

PROCEDURAT E
SHËRBIMIT TË KËRKIMIT

dhe

PROCEDURAT E
DORËZIMIT TË
VËRTETIMEVE TE KNKK-së
PËR PERSONA TË
ZHDUKUR

Qershor 2009

PROCEDURAT E SHËRBIMIT TË KËRKIMIT

I. RRETHANAT QË E SHTYJNË KKK-në TË VEPROJË

Shërbimi i kërkimit i KKK-së është përgjegjës për trajtimin e rasteve kur kontaktet familjare humben dhe arsytet e kësaj humbjeje nuk kanë lidhje me konfliktin në Kosovë. Para hapjes së rastit nga KKK-ja familjet duhet ti kenë shterur të gjitha mundësit për rivendosje të kontaktit.

KKK-ja ndërmer veprime në emër të individëve kur i merr kërkesat nga:

1. Familjarë që jetojnë brenda Kosovës por që kërkojnë të afërmit jashtë vendit (Shoqatat Kombëtare të atyre vendeve duhet të veprojnë në këto raste)
2. Shoqatat Kombëtare jashtë vendit, kur familjarët kërkojnë të afërmit e tyre në Kosovë (Kërkimi aktiv nga KKK-ja).

Llojet më të shpeshta të kërkesave

A. Mesazhet e Kryqit të Kuq (MKK): përdoren kur rrugët e komunikimit mes familjarëve nuk janë të mundshme.

Shkëmbimi i MKK-ve lejohet vetëm për anëtarët e ngushtë të një familjeje. MKK-të e adresuara tek personalitetet politike apo personalitete të rëndësishme të veçantë nuk do të pranohen përveç nëse tregohet se ekziston një lidhje personale midis dërguesit dhe pranuesit të mesazhit.

B. Kërkesa për kërkim: Përdoren kur MKK nuk janë të mjaftueshme për rivendosjen e kontaktit dhe më shumë informata nevojiten për kërkim.

C. Kërkesa për të mësuar për shëndetin dhe mirëqenien: Këto kërkesa duhet të pranohen në raste kur një humbje e befasishme e kontaktit është shkak i brengosjes për shëndetin dhe mirëqenien e një personi

II. Mbledhja e kërkesave në Kosovë

A. Mbledhja e MKK-ve

MKK është letër e hapur, e cila mund të lexohet nga autoritetet.

Formati standard i MKK-ve përmban dy pjesë: pjesa e parë përdoret nga dërguesi për ta shkruar mesazhin e tij/saj, dhe e dyta përdoret për përgjigjen e të afërmeve.

Informatat e kërkuara

- Identiteti dhe adresa e plotë e dërguesit dhe marrësit
- hapësirë për lajme familjare
- lidhja familjare në mes të dërguesit dhe marrësit
- nënshkrimi i dërguesit
- data e mesazhit

Nëse është e mundshme çdo informatë e kërkuar në MKK duhet të plotësohet.

Informata të detajuara lidhur me identitetin e dërguesit dhe marrësit, përfshirë detajet e lidhjen përfshirë emrin e prindërve, si dhe adresa janë vitale për dorëzim të suksesshëm të MKK.

Detajet e adresës mund të ndryshojnë në mes të shteteve, por duhet të përmbajnë rrugën, numrin e shtëpisë, fshatin/qytetin dhe kodin postarë aty ku ai aplikohet. Numri i telefonit, adresa e postës elektronike, etj. duhet gjithashtu të shënohen nëse ato dihen.

Kontrollimi i përmbajtjes së MKK-së

KKK-ja është përgjegjëse për kontrollimin nëse MKK është mbushur në mënyrë korrekte:

- Informatat mbi marrësin dhe dërguesin duhet të jenë të qarta, të lexueshme, complete dhe të sakta.
- Adresa postare duhet të shkruhet në gjuhën e cila përdoret në shtetin e përkatës, ashtu siç shkruhet atje.
- Lidhja familjare në mes të dërguesit dhe marrësit duhet të verifikohet.

MKK-të nuk janë mesazhe private. Autoritetet mund të kërkojnë ti lexojnë ato me qëllim të sigurimit se mesazhi përmban vetëm lajme familjare apo private. KKK-ja si pjesë e Lëvizjes mban përgjegjësi për përmbajtjen e MKK-së të cilin e transmeton.

Lajmet e pranueshme janë ato natyrës private apo familjare nga dërguesi tek marrësi si p.sh.:

- ngjarjet private apo familjare (lindjet, martesat, sëmundjet apo vdekja);
- vendndodhja e anëtarëve të familjes dhe gjendja e tyre shëndetësore;
- kërkesa për lajme nga familjarët apo shokët;
- jeta ditore e familjarëve apo shokëve (punë, shkollë, etj.).

Dokumente zyrtare apo fotografi të natyrës familjare mund të bashkëngjiten (MKK-të me dokumente origjinale duhet të dërgohen me një letër përcjellëse).

MKK duhet të refuzohen nëse përmbajnë mesazhe të natyrës si në vijim:

- informata mbi situatën politike apo ushtarake, përfshirë deklaratat politike;
- informata mbi sjelljet e armëmbajtësve;

- fyerje apo kërcënime;
- gjuhë diskriminuese apo abuzive;
- referime të gabueshme ndaj KKK-së, KNKK-së apo aktiviteteve të Lëvizjes, duke përfshirë kërkesa për ndihmë financiare nëpërmjet kanaleve të Kryqit të Kuq/Gjysmëhënës së Kuqe;
- MKK të drejtuara udhëheqësve politik apo personave të rëndësishëm të veçantë pa pasur lidhje familjare.

Procedurat e censurimit

- KKK-ja duhet të jetë në gjendje të kontrollojë përmbajtjen e secilit MKK të cilin e mbledh, në prezencë të dërguesit. Përndryshe, MKK do të censurohet në degën lokale të KKK-së para se të arrijë në Zyrën Kryesore.
- Secili mesazh duhet të lexohet individualisht dhe të shënohet “Kontrolluar”. Secila fjalë e cila është jashtë kriterëve të përcaktuara duhet të bëhet e palexueshme.
- Nëse shumica e MKK-së është e papranueshme, atëherë duhet të shënohet “Vetëm lajme private dhe familjare” dhe duhet ti dërgohet prapa dërguesit duke shpjeguar qartë arsyen e refuzimit.
- MKK të cilën vijnë nga shtetet e jashtme janë zakonisht të lexuara dhe të pranuar nga Shoqatat Kombëtare të cilat i kanë marrë ato. Mirëpo kjo mund edhe mos të jetë e mundur duke pasur parasysh gjuhën e përdorur. Secili rast i MKK-ve jashtë kriterëve duhet menjëherë ti kthehet Shoqatës Kombëtare në vendin nga i cili ka ardhur, të cilët do të ia kthejnë dërguesit me arsyetimin për mospranim.

B. Mbledhja e kërkesave në Kosovë për kërkime në shtetet e jashtme

Informatat e kërkuara

KKK-ja duhet të sigurohet se informatat të cilat shërbejnë për gjetjen e personit që kërkohet dhe kërkuesit të jenë sa më komplete dhe të sakta në mënyrë që të filloj kërkimi. Sa më të detajuara të jenë shënimet e dhëna nga kërkuesi lidhur me zhdukjen e individit, rriten më shumë mundësitë e kërkimit të suksesshëm.

1. Informatat lidhur me personin që kërkohet:
 - Emri i plotë (ashtu siç përdoret në shtetin përkatës);
 - Nofka apo ndonjë emër tjetër i përdorur;
 - Emri i babait;
 - Emri i nënës;
 - Vendi i lindjes;
 - Data e lindjes (apo mosha);
 - Nënshtetësia (ashtu siç përdoret në shtetin përkatës).
2. Informatat tjera të cilat mund të ndihmojnë:
 - profesioni;
 - statusi martesor;
 - emri i bashkëshortit dhe mosha;
 - emri i fëmijëve dhe mosha;
 - religjioni;
 - klani;
 - etnia.
3. Informatat lidhur me rrethanat në të cilat kontakti është humbur:
 - Data dhe detajet e lajmit të fundit;
 - Adresa e fundit;
 - Informatat e sakta lidhur me humbjen e kontaktit.

4. Informatat shtesë të cilat mund të ndihmojnë kërkimin:
 - Emrat dhe adresat e ndonjë personi i cili mund të jap informata lidhur me vendndodhjen e personit të kërkuar (familjarët, miqtë, bashkëpunëtorët, kolegët e punës etj.);
 - Një përshkrim se si të gjendet shtëpia e personit, në raste kur adresa është e pamjaftueshme (për shembull një vizatim i hartës duke shënuar ndërtesën në të cilën gjendet shtëpia);
5. Identiteti dhe adresa e plotë e kërkuesit:
 - Emri i plotë, data e lindjes (apo mosha), vendi i lindjes, gjinia;
 - Emri i prindërve;
 - Rruga dhe numri i shtëpisë, fshati/qyteti, kodi postar (aty ku aplikohet), komuna, provinca apo rajoni, shteti, numri i telefonit.
6. Lidhja familjare në mes të kërkuesit dhe personit që kërkohet.
7. Lejen (apo moslejimin) e kërkuesit për përdorimin e mediave në proces të kërkimit si dhe paraqitjen e rastit tek autoritetet.
8. Data dhe nënshkrimi i kërkuesit. Nëse kërkesa është paraqitur drejtpërdrejt nga kërkuesi nëpërmjet postës elektronike, duhet të konfirmohen të gjitha të dhënat dhe duhet të merret nënshkrim nga kërkuesi.

Kualiteti i informatave

Degët e KKK-së dhe Zyra Kryesore duhet të sigurohen se informatat e mbledhura janë të mjaftueshme për të bërë kërkimin:

- Kurdo që është e mundur, stafi i KKK-së duhet ti ndihmoj kërkuesit të plotësoi kërkesën për kërkim me qëllim të sigurimit se të gjitha informatat e nevojshme janë të mbledhura. Kjo bëhet duke intervistuar kërkuesin personalisht.
- Kujdes i veçantë duhet ti kushtohet shkrimit të emrave dhe rrethanave të humbjes së kontaktit.
- Informatat duhet të shkruhen në gjuhën e përdorur në shtetin në të cilin dërgohet rasti apo në gjuhë të përdorur zyrtarisht, si p.sh. gjuha Angleze. Nëse është nevoja, Zyra Kryesore e KKK-së duhet ti shkruaj informatat (në një formë) para se ti përcjellë ato.
- Nëse informatat e dhëna paraqiten të pamjaftueshme, informata shtesë duhet të kërkohen nga kërkuesi.

C. Mbledhja e kërkesave për Shëndet dhe Mirëqenie për shtetet e jashtme

Informatat e nevojshme

Përveç informatave personale, fokusi i një kërkesë të tillë është një arsyeje e pashpjegueshme se pse personi ka ndërprerë të shkruaj apo telefonoj. Pasi që kontakti i rregullt ka ekzistuar por është ndërprerë papritmas, kërkuesi duhet të jetë në gjendje të siguroj detajet e nevojshme lidhur me identitetin, gjendjen personale dhe një adresë kontaktuese. Shoqata Kombëtare e cila pranon rastin duhet të njoftohet se cilat hapa i ka ndërmarrë kërkuesi si dhe ndonjë elementi i cili mund të tregoi se çka ka mund të ndodhë personit të kërkuar (problem shëndetësorë, problem social, etj.)

Është me rëndësi të dihet se Kryqi i Kuq/Gjysmëhëna e Kuqe pranon raste me bazë humanitare. Nuk mund të intervenojë në raste të problemeve familjare.

III. PROCESIMI I RASTEVE TË MKK DHE KËRKESAVE TË KËRKIMIT TË PRANUARA NGA SHTETET E JASHTME

A. Dërgimi i MKK në Kosovë

1. Në Kosovë, KKK është përgjegjëse për sigurimin se secili mesazh arrin në vendin e tij dhe se një përgjigje mblidhet shpejt për tu dërguar dërguesit.
2. MKK duhet të distribuohen nga stafi i KKK-së. Kujdes i veçantë duhet treguar në raste kur përcillen lajmet e vështira.
3. Dërgesa e MKK shpesh duket sikur kërkim. Nëse adresa nuk është ajo e siguruar nga dërguesi, stafi i KKK-së duhet të përpiqet të gjejë lokacionin e ri të tij/sajë. Kjo nënkupton se duhet të bëhen pyetje nëpër lagje, intervista me zyrtar lokalë, autoritetet religjioze etj.
4. KKK-ja duhet të përpiqet të mbledh përgjigjen në momentin e dorëzimit të MKK, me qëllim të shmangies së pritjeve nga dërguesi. Nëse marrësi pranon MKK por refuzon të përgjigjet, kërkuesi duhet të jetë i informuar.
5. MKK e padërguar duhet të dërgohet si “kthyer dërguesit” me një shpjegim si p.sh.:
 - Adresa e gabueshme/pamjaftueshme;
 - Pranuesi nuk njihet në adresën e dhënë;
 - Kërkimi për adresën e re i pasuksesshëm;
 - Informata shtesë kërkohen (me disa indikacione lidhur me llojin e informatave të cilat janë të nevojshme / mund të përdoren për kërkime shtesë).
6. Nëse e lejon situata, dërguesi i një MKK të pa dorëzuar mund të hapë kërkesë për kërkim.

B. Kërkimi i personave brenda Kosovës

1. Nëse ekziston një numër i madh i rasteve dhe të gjitha rastet nuk mund të trajtohen menjëherë, prioritet duhet ti ofrohet rasteve ku shëndeti dhe siguria fizike janë të rrezikuara. Prioritet gjithashtu duhet t'u ofrohet edhe grupeve të lëndueshme, si fëmijëve pa përcjellje, personave të moshuar dhe personave me aftësi të kufizuara.
2. Me marrjen e kërkesës për kërkim, shërbimi i kërkimit i KKK-së duhet ti përdorë degët lokale me qëllim të shfrytëzimit të të gjitha mundësive për gjetjen e personit, përfshirë:
 - të vizitohet adresat e fundit private apo të biznesit;
 - të kontaktohet familjarët apo të afërmit;
 - të kontaktohet me udhëheqësit e bashkësisë apo religjionit, shoqatave apo grupeve të refugjatëve;
 - të kontaktohet me autoritetet relevante;
 - të konsultohet regjistrat e lindjes, martesës, vdekjes;
 - të konsultohet arkivat;
 - të konsultohet me përfaqësues nacional apo ndërkombëtarë të OJQ-ve që merren me refugjat, fëmijë apo me grupe tjera të prekura;
 - të konsultohet me rrjetet e informimit publik.
3. Cilado të jetë mënyra e punës KKK-ja duhet ti shmangët shkaktimit të dëmeve qoftë kërkuesit apo personit që kërkohet. Ndarja me publik të disa informatave lidhur me personin që kërkohet mund ta dëmtoj personin që e kërkon atë.
4. Pas lokalizimit të suksesshëm të personit, KKK-ja duhet:
 - Të informoj atë për identitetin e personit që e kërkon atë;
 - Të pyes nëse ai pranon që adresa e tij të ndahet me personin që e kërkon;
 - Të pyes, nëse mënyrat e zakonshme të komunikimit nuk funksionojnë, a ka dëshirë ai person të shkruajë MKK.

5. Nëse kërkimi vërtetohet se personi ka vdekur, kjo informata duhet të vjen nga një burim i besueshëm i informacionit dhe duhet të trajtohet me kujdes.
6. KKK-ja mund të konsideron të mbyllur një rast në situata kur:
 - Kërkuesi ka anuluar kërkesën e kërkimit;
 - Kërkuesi ka vdekur dhe asnjë familjarë nuk dëshiron të vazhdon kërkimin;
 - Kërkuesi është zhvendosur pa lënë informata mbi adresën e re;
 - Kërkimet nuk mund të vazhdojnë pasi që çdo mundësi është shfrytëzuar pa sukses si dhe kërkuesi është informuar;
 - Pasi që një numër i kërkesave të drejtuara tek kërkuesi për informata plotësuese mbeten pa përgjigje.
7. Dega e KKK-së duhet të informon kërkuesin mbi rezultatin e kërkimit, nëpërmjet një shkrese dhe në rast nevojë me MKK, nëpërmjet KKK Zyrës Kryesore dhe KNKK.
8. Një kërkesë për kërkim të mbyllur mund të hapet në secilin moment. Kërkuesit duhet t'i bëhet e qartë se nuk do merret asnjë hapë tjetër përveç nëse situata ndërron apo informata të reja paraqiten.

C. Kërkesa për Shëndet dhe Mirëqenie

Këto kërkesa për nga definicioni janë urgjente. Një adresë dhe kontaktet tjera janë në dispozicion, por pasi që personi ka ndaluar telefonatat apo kontaktet e zakonshme, KKK-ja vizitohet nga familjari dhe kërkohet që në emër të tij të mëson për arsyen e ndërprerjes së kontaktit. Arsyet janë zakonisht lajme shqetësuese për kërkuesin, prandaj duhet të trajtohen me kujdes.

III. Parimet e Punës së Shërimit të Kërkimit

Konfidencialiteti

- Dokumentacioni në posedim të shërbimit të Kërkimit duhet të mbahen në vend të veçante dhe të sigurt, në të cilin vetëm personat e autorizuar mund të kenë qasje.
- Kryqi i Kuq asnjëherë nuk transmeton informata personale tek autoritetet apo palët e treta pa pëlqimin e individëve në fjalë. Ky parim duhet të respektohet jo vetëm për ta ruajtur sigurinë e individëve por gjithashtu për të ruajtur dëshirën e tyre personale.

Respektimi i dëshirës së personave të kontaktuar

Asnjë detaj kontaktues nuk duhet ti komunikohet kërkuesit lidhur me personin e kërkuar pa miratimin e tij. Nëse personi i kërkuar nuk pranon që adresa e tij të ndahet me kërkuesin, ai duhet të tregoi me shkrim se çka duhet thënë kërkuesit:

- Marrësi do ta kontakton kërkuesin më vonë;
- Marrësi nuk dëshiron ta kontaktoi kërkuesin;
- Marrësi nuk njihet/nuk është lokalizuar në adresën e dhënë.

Lajmet Shqetësuese

Kjo mund të nënkupton informimi i personit mbi vdekje apo ndonjë ngjarje të rëndë.

Lajmet e rënda duhet të paraqiten qartë dhe ngadalë në prezencë të personit për përkrahje psikosociale të Kryqit të Kuq apo ndonjë organizate tjetër.

Informata mbi vdekjen nuk duhet të komunikohet nëse nuk është mbledhur nga ndonjë burim i sigurtë apo një dëshmi të dëshmitarit. Në raste kur një konfirmim zyrtar nuk është i mundshëm, zgjedhja më e mire për KKK-në do ishte një MKK e dërguar nga dëshmitari ku ofrohen të dhëna mbi vdekjen e personit që kërkohet.

IV. PROCEDURAT ADMINISTRATIVE

Shënimet e mbajtura nga Shërbimi i Kërkimit i KKK-së

KKK-ja mirëmban një **Regjistër**, shënon dokumentet dhe çdo hap që ndermirët për ti trajtuar ato.

Kjo nënkupton dhënien e një numri referues për secilin rast të hapur dhe një **dosje individuale** në të cilën i tërë dokumentacioni relevant dhe informatat lidhur me atë individ do të mbahen:

- (kopjet e) kërkesave të marra;
- (kopjet e) korrespondencës;
- shënimet mbi hapat e ndërmarra dhe rezultatet;
- kopjet e MKK të shkëmbyera;
- informata shitesë.

Dokumentet duhet të vendosen në dosje individuale në radhitje kronologjike, dokumentet më të reja në fillim.

Dosjet mbahen në radhitje numerike (sipas numrave të rasteve).

Kontrollimi i rasteve të reja

Emri i personave që kërkohen, i kërkuesit apo personave që përmenden në kërkesën për kërkim duhet së pari të kontrollohet me Regjistrin e Shërbimit të Kërkimit për arsyeje se:

- një kërkesë mund të jetë bërë më herët për personin e njëjtë (dosja ekziston);
- personi që kërkohet mund të jetë vet kërkues i ndonjë rasti (e cila do të lejonte një zgjedhje të shpejt të rastit);
- data baza e KKK-së apo shënimet mund të përmbajnë informata të cilat mund të ndihmojnë në zbardhjen e rastit.

Statistikat

Zyra Kryesore e KKK-së mbanë statistika lidhur me:

- MKK të marra nga degët e KKK-së apo individët brenda Kosovës (MKK të mbledhura);
- MKK të dërguara për dorëzim degëve apo individëve në Kosovë (MKK të dorëzuara);
- MKK të pa dorëzuara / të kthyer tek dërguesi.
- numri i kërkesave të hapura (brenda/jashtë);
- numri i rasteve të mbyllura (brenda/jashtë), dhe rezultati;
- numri i rasteve nën procedim (brenda/jashtë).

Statistikat duhet të kenë edhe ndonjë koment lidhur me llojin e kërkesave dhe rezultatin e rasteve.

Shkëmbimi i dokumenteve

- E tërë korrespondenca me KNKK-në dhe Shoqatat tjera kombëtare centralizohet në Zyrën Kryesore të KKK-së.
- Shkëmbimi i dokumenteve (Mesazhet e Kryqit të Kuq, kërkesat për kërkim, rezultatet e kërkimit, etj.) **në mes të Zyrës Kryesore dhe degëve të KKK-së** bëhet përmes një shkresë, brenda 5 ditëve nga mbledhja/pranimi i dokumentit.
- Koordinatorja i Shërbimit të Kërkimit të KKK-së do të kontrollojë Mesazhet e Kryqit të Kuq / kërkesave /informativë të trajtuara nga degët, nëse është në Rregull, do ta dërgojmë një shkresë Shoqatave Kombëtare, nëpërmjet KNKK-së.
- Me qëllim të përcjelljes së korrespondencës **mes KNKK-së dhe Zyrës Kryesore të KKK-së**, i tërë dokumentacioni duhet shkëmbyer me një shkresë përcjellëse e cila i liston të gjitha dokumentet (llojin e dokumentit, subjekti, numri referues dhe emri për raste individuale).
- Në rast se nuk ka përgjigje brenda kohës së caktuar (dhjetë ditë pune), një letër përkujtuese do të dërgohet.

Shpërndarja e Dokumenteve të KNKK nga KKK

Letra Konfirmuese për Personin e Zhdukur (LKPZh)

- Dëshmon se personi në fjalë është raportuar si i zhdukur nga familja e tij/saj dhe rasti është ende i hapur në të dhënat që posedon KNKK.
- Mund të lëshohet më shumë se një herë por nuk ipet më shumë se dy herë brenda vitit.
- Lëshohet me kërkesë të familjes. Anëtari i familjes duhet të plotësoj kërkesën për Letër Konfirmuese për Personin e Zhdukur dhe duhet të nënshkruaj që e ka pranuar letrën.

Letra Konfirmuese (LK)

- Dëshmon se personi në fjalë ka qenë i raportuar si i zhdukur tek KNKK por pas identifikimit dhe varrimit të trupit, rasti është mbyllur.
- Rastet e mbyllura deri ne 31 Dhjetor 2004 janë rastet për të cilat ipet kjo letër. Kjo lidhet me faktin se që nga Janari 2005, KNKK-ja ka filluar të aplikoj procedure të re për mbylljen e rasteve (shiko informatat tek pjesa ku flitet për Letrat për Mbyllje të Rastit).
- Lëshohet vetëm një herë.
- Lëshohet me kërkesë të familjes. Anëtari i familjes plotëson kërkesën për Letër Konfirmuese dhe nënshkruan në momentin kur e pranon atë.

Letrat për mbylljen e Rastit (LMR)

- Zyrtarisht njofton familjen se rasti që ka qenë i hapur për familjarin e tyre të zhdukur është mbyllur, pas informatave zyrtare që trupi (mbetjet mortore) është identifikuar dhe i është dorëzuar familjes.
- Kjo letër ipet vetëm një herë.

- Ipet sistematikisht nga KNKK-ja për të gjitha rastet e mbyllura (të zhdukurit e identifikuar) nga Janari 2005.
- Preferohet që kjo Letër të i ipet familjes dy ose tri javë pas varrimit. Gjatë vizitës plotësohet forma për Dorëzimin e Letrës për Mbyllje të rastit e cila përmban disa detaje rreth personit të zhdukur, personit që e pranon letrën etj.

A. Procedurat për Letra Konfirmuese për Personin e Zhdukur (LKPZh) dhe Letra Konfirmuese (LK)

1. *Marrja e Kërkesës*
 - Kur familjari viziton degën e Kryqit të Kuq stafi së pari duhet të verifikoj se a është rasti i njohur (dhe a është nga konflikti në Kosovë) duke shikuar Librin e KNKK-së për persona të Zhdukur ose duke kontaktuar drejtpërsëdrejti me Zyrtarët e KNKK-së në Prishtinë (për LKPZh duhet të shikohet edicioni i fundit i Librit kurse për LK duhet të shikohen edicionet e mëparshme për rastet e mbyllura). Stafi i degës duhet të shpjegoj kriteret për lëshimin e letrës në mënyrë që t'u shmanget përgjigjes negative nga KNKK.
 - Në veçanti, stafi duhet të pyes personin cili bën kërkesën për LKPZh apo LK se a kërkuar/pranuar ndonjë dokument të tillë më parë nga KNKK dhe nëse po kur. Shpjego se një letër mund të lëshohet vetëm një here brenda 6 muajve.
2. *Kur pranohet Kërkesa:*
 - Dega e KKK-së e dërgon kërkesën e plotësuar në zyrën kryesore brenda një jave.
 - ZK e KKK-së e regjistron kërkesën dhe e dërgon tek KNKK-ja, departamenti i mbrojtjes, pa vonesë.
3. *Lëshimi dhe dorëzimi i letrave*

- KNKK lëshon dokumentin e kërkuar (letrën) dhe e dërgon në ZK të KKK-së së bashku me Kërkesën për Letrën në fjalë (KNKK.-ja mban një kopje të Kërkesës deri sa të kthehet origjinali i saj me nënshkrim të familjarit se e ka pranuar letrën).
- Për rastet të cilat nuk i plotësojnë kriteret, KNKK-ja ofron përgjigje negative me shkrim.
- ZK e KKK-së e rifreskon regjistrin me informata të reja dhe ia përcjell/dorëzon dokumentin degës së KKK-së brenda një jave.
- Dega e KKK-së duhet të ia dorëzoj dokumentin familjes sa më shpejt që mundet. Zyrtari i terrenit i KNKK-së është i gatshëm të ofroj përkrahje po që se shfaqet nevoja.
- Personi që pranon letrën duhet të nënshkruaj në pjesën "Pranoi" të Kërkesës e cila duhet të kthehet në ZK të KKK-së brenda një jave.
- ZK e KKK-së e rifreskon regjistrin e saj dhe e përcjell formën tek KNKK-ja, departamenti i mbrojtjes.

Procedurat për Letrat e Mbylljes së Rastit

Procedurat janë të njëjta, përveç se për këto letra nuk duhet të plotësohet kërkesë nga familja.

1. KNKK-ja lëshon këtë letër momentin kur zyrtarisht njoftohet se rasti është mbyllur (zakonisht atëherë kur mbetjet mortore identifikohen dhe i dorëzohen familjes). Kjo letër dërgohet tek ZK e KKK-së-
2. ZK e KKK-së e fut në regjistër këtë letër dhe e përcjell tek dega e saj në periudhën brenda një jave.
3. Dega e KKK-së ia dorëzon letrën familjes, dhe plotëson formën për Dorëzimin e Letrës për Mbyllje të rastit e cila duhet të kthehet mbrapa në ZK të KKK-së brenda një jave.
4. ZK e KKK-së e rifreskon regjistrin dhe përcjell formën e Dorëzimit tek KNKK-ja.

B. Procedurat Administrative

Konfidencialiti

Çdo informate lidhur me personin e zhdukur që posedon KKK-ja është konfidenciale. Vetëm shënimet e dhëna në Librin e të Zhdukurve mund të ipen publikisht si psh:

- Numri i KNKK-së
- Emri (emri i prindit) i personit të kërkuar
- Gjinia
- Data dhe vendlindja
- Data, vendi dhe komuna ku/kur është parë për here të fundit.

Shënime personale për anëtarët e familjes (kërkuesit) nuk guxojnë të I ipen asnjë autoriteti apo pale të tretë pa konsultim paraprak me KNKK.

Shënime që mbahen nga Shërbimi i Kërkimit të KKK-së (ZK)

KKK-ja duhet të mbajë një regjistër në Excel (apo Word) në mënyrë që të regjistroj dokumentet dhe çdo hap të ndërmmarrur. Kjo nënkupton caktimin e një numri referues për secilin rast dhe hapjen e një dosjeje për mbajtjen e të gjitha informatave dhe dokumenteve relevante:

- kërkesa për LKPZh, LK dhe LMR
- kopjet e korrespondencës;
- informatat plotësuese.

Statistikat:

ZK e KKK-së duhet të mbajë statistika të rregullta lidhur me:

- numrin e LKPZh të dorëzuara
- numrin e LK
- numrin e LMR

Përcjellja e postës mes KNKK-së dhe Shërbimit të Kërkimit të KKK-së (ZK)

Në mënyrë që të përcillet korrespondenca mes KNKK-së dhe ZK të KKK-së e gjithë posta shkëmbehet me një letër shkresë ku listohen të gjitha dokumentet (lloji dokumentit, tema, numri referues dhe emrat e rasteve individuale).

Nëse nuk pranohet përgjigje brenda dy javëve atëherë KNKK-ja i dërgon letër përkujtuese KKK-së.

Informata bazike mbi procedurat dhe modalitetet e punës së KNKK'së

Të gjitha formularët e mbledhur në terren lidhur me personat e zhdukur, përcillen dhe arkivohen në KNKK Shkup. Informatat e nevojshme për tu proceduar në data bazën (Prot 5), kryhen nga zyra në Shkup dhe duke pasur parasysh se lëshimi i letrave zyrtare është i ndërlidhur me të dhënat e fundit të nxjerra nga data baza (Prot 5), të gjitha letrat janë të lëshuara nga zyra në Shkup.

Me rëndësi: Të gjitha llojet e dokumenteve lëshohen **vetëm** për raste të cilat janë paraqitur si të zhdukur nga ana e familjarëve të tyre dhe të cilat janë të evidentuar në data bazë të KNKK-së (Prot 5).

Vetëm familjarët e afërt të personit të zhdukur kanë të drejtë të kërkojnë/pranojnë letër (bashkëshorët, prindërit, fëmijët). Në përgjithësi letra duhet t'i dorëzohet personit i cili kujdeset për fëmijët e personit të zhdukur apo prindërve të personit të zhdukur.

KNKK-ja konsideron se të gjitha rastet e personave të zhdukur në mes të periudhës Janar 1998 dhe Dhjetor 2000 në territorin e Kosovës konsiderohen si raste të konfliktit dhe si të tilla hyjnë në mandat të KNKK-së. Të gjitha rastet trajtohen njëllëj, pa diskriminime etnike, religjioze apo sociale.

Ne besojmë se e njejta qasje do të aplikohet në të ardhmen nga Kryqi i Kuq.

Letër Konfirmuese për Personin e Zhdukur

Kjo letër konfirmon se personi është raportuar si i zhdukur nga familja e tij/saj dhe se rasti është ende i hapur sipas shënimeve të KNKK-së.

Kjo letër lëshohet e bazuar në kërkesën e familjes, çka do të thotë se lëshohet vetëm në raste kur të paraqitet familjari me një kërkesë të tillë. Pasur parasysh afatet kohore, kjo letër mund të lëshohet më shumë se një herë, në raste kur letra e fundit është lëshuar para një viti. Ajo letër do të ketë pamje të njëjtë, vetëm data e lëshimit do të korrektohet.

Ashtu siç ka qenë rasti me zyrtarët e terrenit të KNKK-së, degët do të jenë paksa të hendikepuara pasi që ato nuk do të kenë në posedimin e tyre data bazën e cila do të tregon gjendjen e fundit të rasteve (për të ditur se a mund të lëshojnë letër apo jo).

Ne sugjerojmë që degët të jenë të pajisura me detajet kontaktuese të dy zyrtarëve të KNKK-së (Agonin/Naimin) që ata të kontaktohen drejtpërdrejt kur degët të jenë të ballafaquara me kërkesë për letër.

Kërkesa për Letër Konfirmuese për Personin e Zhdukur duhet të plotësohet dhe nënshkruhet nga familjari i personit të zhdukur dhe pasi që letra t'i dorëzohet anëtarëve të familjes, Dorëzimi i Letrës Konfirmuese për Personin e Zhdukur duhet të plotësohet dhe nënshkruhet.

Është me rëndësi të informohet familja se Letra Konfirmuese për Personin e Zhdukur to të lëshohet nga KNKK në Shkup, prandaj kjo do të merr kohë (së paku një muaj) derisa letra të arrijë në degën e caktuar.

Letra konfirmuese

Kjo letër konfirmon se personi ishte paraqitur si i zhdukur tek KNKK-ja dhe se rasti është identifikuar dhe trupi është varrosur, prandaj rasti është i mbyllur.

Kjo letër lëshohet vetëm njëherë dhe me kërkesë të familjes; të gjitha rastet e mbyllura para 31 Dhjetorit të vitit 2004 kanë të drejtë të marrin këtë letër. Kjo ka të bëjë me fakti se që nga Janari 2005, KNKK-ja në Prishtinë filloi me një procedurë të re të mbylljes së rastit (shiko Formularë për Mbylljen e Rastit) Njësoj sikur Letra Konfirmuese për Personin e Zhdukur, Kërkesa për letrën konfirmuese duhet të mbushet dhe nënshkruhet nga anëtarët e familjes, pasi që Letra Konfirmuese të dorëzohet Dorëzimi i Letrës Konfirmuese duhet të mbushet dhe nënshkruhet nga anëtarët e familjes të cilët marrin atë.

Letra për mbyllje të rastit

Siç u përmend më lartë, që nga Janari 2005 për të gjitha rastet e identifikuar, KNKK lëshon letrën e cila dorëzohet tek familja gjatë vizitës së fundit që i bëhet asaj.

Kjo letër lëshohet vetëm njëherë dhe konfirmon se personi në fjalë, është raportuar si i zhdukur dhe se pas identifikimit dhe dorëzimit të mbetjeve mortore, KNKK-ja ka mbyllur rastin.

Letra do të duhej të dorëzohej gjatë dy-tri javëve të para pas varrimit. Kjo letër shprehë ngushëllimin e KNKK-së ndaj familjes. Pas dorëzimit të kësaj letre, duhet plotësuar Formularin për Mbylljen e Rastit, i cili përmban disa informata bazike si: data dhe vendi i varrimit, personi i cili pranon letrën etj. (ky dokument nuk ka nevojë për nënshkrim familjar)

Afatet kohore / Procedurat

Të gjitha formularët e mbledhura nga KKK duhet të dorëzohen në Zyrën Qendrore të KKK-së. Me qëllim të mbajtjes së shënimeve lidhur me rastet e dërguara apo pranuar, KNKK-ja do të shkëmbejë "postë" javore me KKK-në.

REGJISTRI I KKK-SË PËR DORËZIMIN E DOKUMENTEVE TË KKK-SË												
S/No	ICRC No	Emri i plotë i personit të zhdukur	Lloji i letrës	Dega	Kërkesa e pranuar	Kërkesa e ardhur në ZK	Kërkesa dërguar KNKK-së	Letra nga KNKK e pranuar	Letra dërguar në degë	Letra e Dorëzuar	Forma për dorëzim të letrës e kthyer në ZK	Forma e kthyer tek KNKK
08/01	BLG-200315	KRASHNI QI Hasan	MPCL	Pej	01.09.08	05.09.08	06.09.08	01.10.08	03.10.08	10.10.08	15.10.08	17.10.08
08/02			ClosL	Vit				02.10.08	03.10.08	09.10.08	11.10.08	
08/03			ClosL	Gja				02.10.08	04.10.08			
08/04			ClosL	Gja				02.10.08	04.10.08			
08/05			MPCL	Gja	15.07.08	05.10.08	07.10.08	20.10.08	23.10.08	30.10.08	05.11.08	06.11.08
08/06			MPCL	Kli	08.09.08	06.10.08	10.10.08	20.10.08	23.10.08			
08/07			MPCL	Kli	30.09.08	06.10.08	10.10.08	20.10.08	23.10.08			
08/08			ClosL	Vit				22.10.08	25.10.08			
08/09			ClosL	Kli				22.10.08	23.10.08			
08/10												

Dorëzimi i Letrës për Mbylljen e Rastit
Delivery of Letter of Closure

Me këtë vërtetohet dorëzimi i Letrës për Mbylljen e Rastit:
This is to confirm the hand-over of the Letter of Closure concerning

Emri i plotë: _____ **Numri i KNKK-së:** _____
Full name ICRC N°

Personi i cili e pranon Letrën:
Person receiving the letter

Emri i plotë: _____ **Gjinia: M / F**
Full name Sex

Adresa: _____
Present address

Komuna: _____
Municipality

Lidhja familjare me personin e zhdukur: _____
Family relation with the missing person

Data: _____ **Vendi:** _____
Date Place

Dega e Kryqit të Kuq: _____ **Sekretari/vullnetari:** _____
Red Cross Branch Secretary/volunteer



Conf. Letter

Our ref. / Ref. e jonë: [REDACTED]

TO WHOM IT MAY CONCERN

This letter confirms that on 02.08.1999 in the International Committee of the Red Cross (ICRC), a tracing request was opened for Mr. [REDACTED] (father's name *Tahir*) born on 17.09.1974 in Zablace, Istok municipality, whose whereabouts were unknown since 08.05.1999.

Following our visit to the family on 03.10.2007, we were informed by [REDACTED], the father of the concerned person, that he was found dead and was buried on 03.09.1999, after which the ICRC has closed this case.

This letter is issued on the request of the family.

KUJIDO QË I PËRKET

Me këtë letër vërtetohet se më 02.08.1999 në Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), është hapur një kërkesë për personin e zhdukur, për zotëri [REDACTED] (emri i babait *Tahir*) i lindur më 17.09.1974 në Zabllaq komuna e Istogut, për të cilin nuk dihej se ku gjendet pas 08.05.1999.

Pas vizitës sonë në familje më 03.10.2007, jemi informuar nga [REDACTED] babai i personit në fjalë, se ai është gjetur i vdekur dhe është varrosur më 03.09.1999, kështuqë KNKK e ka mbyllur këtë rast.

Kjo letër lëshohet me kërkesë të familjes.

Skopje, 21.11.2007

For the ICRC
Për Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq
Matijs van der Meulen
Head of Mission
Shefi i misionit

KËRKESË PËR LETËR KONFIRMUESE PËR PERSONIN E ZHDUKUR
REQUEST FOR MISSING PERSON CONFIRMATION LETTER

TË DHËNAT E PERSONIT TË ZHDUKUR
DATA ON MISSING PERSON

Numri i KNKK-së:
ICRC No

Emri i plotë:
Full Name

Emri i babait:
Father's Name

Data dhe vendi i lindjes:
Date and place of birth

Data e zhdukjes:
Date of disappearance

Vendi i zhdukjes:
Place of disappearance

Shteti i zhdukjes:
Country of disappearance

KËRKESA E BËRË NGA

REQUEST MADE BY

Emri i plotë: _____

Full Name

Personin e zhdukur e kam: _____

The missing person is my:

Adresa (FSHATI/KOMUNA ose RRUGA/QYTETI): _____

Full Address

Numri i Tel: _____

Phone No

Arsyeja e kërkesës: _____

Confirmation needed for

Gjuha e letrës*: _____

Language of Letter*

Nënshkrimi i personit që kërkon letrën: _____

Requester's Signature

Data: _____

Date

LETRA KONFIRMUESE PRANOHET

CONFIRMATION LETTER RECEIVED

Vendi: _____

Place

Data: _____

Date

Nënshkrimi i personit që pranon letrën: _____

Receiver's Signature

* Letra Konfirmuese mund të lëshohet në gjuhën Angleze dhe në një gjuhë tjetër

* Confirmation letters can be issued in English plus one national language



Missing P.C. Letken

Our ref. / Ref. e jonë: [REDACTED]

TO WHOM IT MAY CONCERN

This letter confirms that on 22.10.1998 in the International Committee of the Red Cross (ICRC), a tracing request was opened for *Mr. Damjani Muharem* (father's name *Qazim*) born on 14.09.1955 in Djakovica, whose whereabouts are unknown since 30.09.1998.

To date the ICRC considers the case concerning the above mentioned person still open.

KUJTO QË I PËRKET

Me këtë letër vërtetohet se më 22.10.1998 në Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), është hapur një kërkesë për personin e zhdukur, për zotëri Damjani Muharem (emri i babait Qazim) i lindur më 14.09.1955 në Gjakovë, për të cilin nuk dihet se ku gjendet pas 30.09.1998.

Deri më sot KNKK e konsideron ende të hapur rastin e personit të lartpërmendur.

Skopje, 21.11.2007

For the ICRC
[Signature]

Head of Mission
Shefi i misionit